

DITARI MUJOR SHKURT 2025



“PAKETA E MALEVE” LEHTËSIRA PËR INVESTI- TORËT NË ZONAT MALORE

Zv. Ministri Sokol Duma prezantoi projektligjin e “Paketës së Maleve”, që synon nxitjen e investimeve dhe zhvillimin e ekonomisë malore përmes lehtësirave fiskale, infrastrukturës të përmirësuar dhe mbështetjes për bizneset, fermerët dhe turizmin malor, si dhe kalimin e pronësisë me tarifë simbolike prej 1 euro për poseduesit faktikë. Paketa krijon mundësi për zhvillimin e industrive të qëndrueshme dhe hapjen e vendeve të reja pune.

Më 19 shkurt, MEKI përshëndeti vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për vijimin e procedurave për miratimin e projektligjit, i cili është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky ligj do të sigurojë zhvillim dhe mbrojtje të zonave malore, duke krijuar mundësi të qëndrueshme për ekonominë.

REFORMA E PENSIONEVE NË SHQIPËRI



Në Konferencën Ndërkombëtare mbi Reformën e Pensioneve në Shqipëri, në prani të Kryeministrit, përfaqësuesve të Bankës Botërore, AMF dhe ekspertëve vendas e ndërkombëtarë, u diskutuan sfidat dhe risitë për një sistem pensionesh më të qëndrueshëm.

Në fokus ishin reduktimi i informalitetit, rritja e produktivitetit ekonomik, përmirësimi i skemave të kontributit dhe mbështetja për familjet e reja. Pavarësisht suksesit të reformave të deritanishme, nevojitet përkushtim dhe veprime konkrete për të garantuar një jetë dinjitoze për pensionistët e sotëm dhe të ardhshëm.

DURANA TECH PARK – QENDRA E RE E INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË

Durana Tech Park ka hapur dyert virtuale, duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e një ekosistemi inovativ në zemër të korridorit ekonomik Tiranë-Durrës. Ky park do të bashkojë bizneset shqiptare dhe ndërkombëtare, startup-et, institucionet akademike, kërkimin shkencor dhe nomadët digjitalë, duke ofruar infrastrukturë moderne fizike dhe virtuale. Për ekonominë shqiptare, Durana Tech Park do të sjellë përfitime të rëndësishme, përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja, krijimin e vlerës së shtuar dhe modernizimin e fuqisë punëtore. Gjithashtu, do të mbështesë startup-et dhe zhvillimin e arsimit përmes programeve të akselerimit dhe inkubimit. Durana ka potencialin të bëhet një qendër kyçe për investitorët dhe inovatorët që duan të ndërtojnë të ardhmen e teknologjisë në Shqipëri.



DREJTËSIA SOCIALE NË EPOKËN DIGJITALE, INTELIJENCA ARTIFICIALE DHE PUNA

Zv. Ministria Znj. Olta Manjani përfaqësoi Shqipërinë në Konferencën e Nivelit të Lartë “Drejtësia Sociale në Epokën Digjitalë”, ku u diskutua ndikimi i Intelligjencës Artificiale në punë dhe shoqëri. Në panelin “Si mund të shfrytëzohet inteligjenca artificiale për të kontribuar në punë të denjë



dhe drejtësi sociale”, u theksua se AI duhet të jetë një mjet për zhvillim ekonomik dhe drejtësi sociale, duke garantuar të drejtat e punëmarrësve dhe barazinë gjinore. Diskutimi përfshiu tema si integrimi i teknologjisë për një tranzicion të drejtë, garantimi i mundësive për të gjithë punëtorët, dhe bashkëpunimi midis qeverive, bizneseve dhe partnerëve socialë për të hartuar politika të intelligjencës artificiale.

SHQIPËRIA NË KOMITETIN E PRONËSISË INTELEKTUALE (ACE)

Shqipëria ka mbajtur për herë të parë pozicionin e Zëvendës-Drejtueses në sesionin e 17-të të Komitetit Këshillimor të Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale (ACE) në OBPI, përfaqësuar nga znj. Borana Ajazi, Drejtoreshë e të Drejtës së Autorit. Ky emërim ka theksuar angazhimin e Shqipërisë në zhvillimin e politikave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale. Gjatë sesionit, u zhvillua një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të OBPI, z. Daren Tang, për të diskutuar progresin dhe mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe OBPI.



SOKOL BARDHI EMËROHET DREJTOR I PËRGJITHSHËM I QKB

Sokol Bardhi, i cili ka udhëhequr zhvillimin e politikave për inovacionin dhe teknologjinë në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, tashmë merr drejtimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit si Drejtor i Përgjithshëm.

Me një formim të fortë akademik dhe përvojë në transformimin dixhital, ai do të vijojë kontributin e tij në lehtësimin dhe modernizimin e shërbimeve për bizneset në Shqipëri.

Z. Bardhi u prezantua në deytirën e re nga Znj. Blerta Rama, Zv/Ministre e MEKI.

NJOHJA E VITEVE TË PUNËS PËR PENSION

Parlamenti miratoi Ligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore dhe ish-ndërmarrjet bujqësore”, një nismë e MEKI dhe ISSH, që zgjidh një problem të gjatë për mijëra qytetarë që ishin përballur me vështirësi për njohjen e viteve të punës për efekt pensioni për shkak të mungesës së dokumenteve.

Ky ligj eliminon burokracitë dhe procedurat e gjata gjyqësore, duke njohur automatikisht periudhat e punësimit para vitit 1994 dhe përmirëson jetën e mbi 30 mijë qytetarëve që përfitojnë pension çdo vit.

Ky ligj shënon mbylljen e një kapitulli të padrejtësisë, duke i dhënë mundësinë qytetarëve të dalë në pension të sigurojnë të drejtat e plota dhe një pension më të drejtë. Me këtë hap, qeveria ka garantuar një sistem pensionesh më të qëndrueshëm dhe ka kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve në moshë pensioni.

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHODERORE

PËRFITIMET:

- NJOHJE AUTOMATIKE E VITEVE TË PUNËS**
- RRITJE E SHUMËS SË PENSIONIT**
- DREJTËSI PËR MBI 30,000 PENSIONE TË REJA ÇDO VIT**
- ELIMINIM I MBI 3,000 PROCESVE GJYQËSORE NË VIT**

www.meki.gov.al



SHQIPËRIA DHE SLLOVENIA FORCOJNË BASHKËPUNIMIN NË PUNËSIM DHE SIGURIME SHOQËRORE

Në një takim me Zëvendëskryeminstriin e Sllovenisë, Z. Luka Mesec, dhe Ambasadorin e Sllovenisë në Shqipëri, Z. Jakob Štunf, u diskutua për arritjen e një Marrëveshjeje Dypalëshe që do të mundësojë krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe sigurimeve shoqërore. Ky bashkëpunim nënvizon angazhimin e përbashkët për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe për të siguruar politika sociale më të qëndrueshme, duke rritur mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe përmirësuar sistemet e sigurimeve shoqërore.

LEHTËSIM PËR TREGTINË, CERTIFIKATAT E ORIGJINËS DO TË JENË DIXHITALE



Në Kuvend u miratua Projektligji “Për ratifikimin e vendimit nr.1/2024 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane”, i cili lejon përdorimin e certifikatave elektronike për qarkullimin e mallrave. Ky ligj, i cili hyn në fuqi në janar 2025, synon të lehtësojë tregtinë ndërkombëtare dhe të modernizojë procedurat doganore.

INVESTIM I RI NË TEKNOLOGJI NË TEDA TIRANË

Nënshkrimi i marrëveshjes mes “TEDA Tiranë” dhe kompanisë izraelite “H.A.P.I Advanced Technologies LTD” është një investim i rëndësishëm në teknologji dhe inovacion. Ky projekt strategjik synon të nxjerrë përfitime për Shqipërinë, duke ofruar lehtësira për investimet e huaja në sektorë të ndryshëm si teknologjia, automotive dhe prodhimi. TEDA Tiranë ka për qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset, që do të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe promovimin e sektorëve të teknologjisë dhe inovacionit.



ECIN ME RITEM PUNIMET NE MUZEUN E ARTEVE TE BUKURA

Puna për transformimin e Galerisë Kombëtare të Arteve në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura vazhdon me intensitet. Ministri Gonxhja së bashku me Kryeministrin Rama, inspektuan ecurinë e punimeve, ku përforcimi i strukturës dhe zgjerimi i hapësirave do ta shndërrojë



muzeun në një qendër moderne arti. Hapësirat ekspozuese janë dyfishuar, arkivat trefishuar dhe hapësirat për evente janë dhjetëfishuar. Deri tani, janë restauruar 784 vepra arti dhe arkivat po digjitalizohen për një akses më të lehtë dhe ruajtje afatgjatë.

“MARIONETAT E TRASHËGIMISË”, ARTI QË LIDH BREZAT

Projekti “Marionetat e Trashëgimisë”, i mbështetur nga EU4Culture dhe financuar nga Bashkimi Evropian, sjell trashëgiminë kulturore më pranë fëmijëve dhe të rinjve përmes teatrit të kukullave. Shfaqja e Teatrit të Kukullave do të riaktualizohet në një format modern dhe interaktiv, duke ofruar gjithashtu aktivitete edukative për fëmijët, të cilët do të mësojnë për trashëgiminë në një mënyrë argëtuese.



Ky projekt ka një energji fantastike, duke u shndërruar në një shembull të bukur të mundësisë që arti ofron për të lidhur brezat në një mënyrë kreative dhe frymëzuese.



PROGRAMI EU4CULTURE, MBËSHTETJA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Në Takimin e 7-të të Komitetit Drejtues të Programit #EU4Culture, MEKI, Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe UNOPS diskutuan mbi arritjet, sfidat dhe prioritetet për fazën finale të programit. U theksuan ngjarjet kyçe si inaugurimi i Teatrit të Kukullave dhe muzeve etnografike në Krujë dhe Kavajë, ndërsa 18 site kulturore janë restauruar dhe 5 të tjera janë në proces.

Përveç restaurimit, u pasqyrua ndikimi i programit në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe rritjen e kapaciteteve për menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. MEKI vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së dhe angazhimin e UNOPS për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

VIJOJNË PUNIMET NË TEATRIN E RI KOMBËTAR

Në kantierin e Teatrit të Ri Kombëtar, projekti i arkitektit të njohur Bjarke Ingels, ku punimet kanë kaluar në fazën e avancuar pas përfundimit të punimeve nëntokësore. Ky teatër do të përfundojë brenda vitit dhe do të jetë një nga teatrot më të bukura në Europë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky investim i rëndësishëm është një hap i madh drejt vizionit të Shqipërisë, për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, duke ofruar një infrastrukturë kulturore moderne dhe tërheqëse.



SHQIPËRIA AVANCON NË NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM NË BE

Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të negociatave për anëtarësim në BE, me hapjen e Grupkapitujve 2 dhe 3, të cilët janë thelbësorë për zhvillimin ekonomik dhe forcimin e konkurrueshmërisë në tregun evropian. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit udhëheq bisedimet në 10 prej 17 kapitujve negociues, duke luajtur një rol kyç në këtë proces.

Grupkapitulli 2 përfshin 9 kapituj, ku MEKI udhëheq 7 prej tyre, duke adresuar çështje të rëndësishme për lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe punës. Grupkapitulli 3, që ka 8 kapituj, ka 3 të tillë që udhëhiqen nga MEKI, me fokus në politikat e konkurrues, ndihmën shtetërore dhe zhvillimin e sektorëve strategjikë. Angazhimi për reforma strukturore dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së po e afron Shqipërinë me familjen europiane.



SHQIPËRIA FORCON LIDHJET EKONOMIKE ME GJERMANINË

MEKI, përfaqësuar nga Zëvendësministrja Znj. Blerta Rama, mirëpriti një delegacion të Forumit Parlamentar për Evropën Lindore dhe Qendrore nga Saksonia, Gjermani. Gjatë takimit u diskutuan mundësitë që Shqipëria ofron në sektorë të rëndësishëm ekonomikë dhe konkurrues, si dhe bashkëpunimi i ngushtë mes Shqipërisë dhe Gjermanisë. Znj. Rama theksoi prioritetet e MEKI-t për forcimin e marrëdhënieve me Gjermaninë dhe Saksoninë, duke përfshirë mbështetje në projekte teknike, integrimin evropian dhe zhvillimin e turizmit, si dhe inkurajoi investimet gjermane në Shqipëri.



PROGRESI I SHQIPËRISË NË PROKURIMIN PUBLIK

Raporti i fundit i OECD/SIGMA vlerëson përparimin e Shqipërisë në fushën e prokurimit publik, duke theksuar përmirësimin e prokurimit të përqendruar përmes krijimit të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara. Shqipëria është pozicionuar si një nga vendet më të avancuara në rajon, duke udhëhequr edhe disa aspekte të prokurimit në Ballkanin Perëndimor.

Raporti vlerëson përmirësimet në legjislacion, strategjitë e reja, ngritjen institucionale dhe zbatimin efikas të politikave, që kanë kontribuar në modernizimin e sistemit të prokurimit publik, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe konkurrueshmërinë.

